MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS

SHËRBIMI I PROVËS

BULETIN Nr. 4
2014

© Shërbimi i Provës, 2015
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përgatitur nga: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
Përgatiti për botim: Enkel Bulica
Redaktimi shkencor dhe letrar: Edlira Agolli, Prezenca e OSBE-së
në Shqipëri

Design & Layout:
Kopertina:
ISBN: 978-92-9235-268-4

Ky botim u mbështet nga

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri
www.osce.org/albania

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë detyrimisht
ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

Fakte të shpejta 4
Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës 5

HYRJE

Fjalë përshëndetëse nga z. Ilir Qafa, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës 7

Kreu I. SHËRBIMI I PROVËS NË SHQIPËRI – NJË PAMJE E PËRGJITHSHME 8
Hyrje 8
Misioni i Shërbimit të Provës 8
Shërbimet e ofruara për institucionet dhe publikun 9
Alternativat e dënimit me burgim 10
Kutia informative 1 - Detyrimet 10
Kutia informative 2- Shkelja e detyrimeve 11
Rritja e sigurisë së publikut 11
Ulja e recidivizmit 11
Kush përfiton? 12
Kuti informative 3 - Kriteret e përfitimit të dënimit alternativ 12

Kreu II. PARIMET DHE KONCEPTET NË THEMEL TË SHËRBIMIT TË PROVËS 13
Përgjegjësitë e Shërbimit të Provës 13
Kuti informative 4 - Shërbimi i Provës - anëtar i CEP 13
Çfarë do të thotë mbikëqyrja e një rasti? 14
Asistimi dhe konsultimi 14
Vlerësimi 15
Trajtimi 15
I dënuari është i rëndësishëm 15
Rast praktik: Pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia
në periudhë prove (Neni 59) 15

Kreu III. VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË 17

Kreu IV. SHËRBIMI I PROVËS GJATË FAZAVE TË PROCEDIMIT PENAL 19
Hapat e procedurës standarde për “lirimin me kusht” 19
Rast praktik : Lirimi me kusht 21
Hapat e procedurës standarde për “qëndrimin në shtëpi” 22
Rast praktik: Qëndrimi në shtëpi 23

Kreu V. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA 24
Organet e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor 24

Kuti informative 5 - Funksioni i komunitetit në shoqëri 25
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve 26
Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit 26
Drejtoritë Arsimore Rajonale 26

Kreu VI. RRJETI BASHKËPUNUES PËR TRAJTIMIN E NEVOJAVE TË TË DËNUARIT 27
Aksion + 27
Komuniteti "Emanuel" 27
Fondacioni "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" (FZKPM) 27
Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI) 28
Aktiviteti i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) (Tirana Legal Aid Society) 28
Qendra Komunitare Multifunksionale Gjirokastër 28
"ARSIS" Organizata Shoqërore e Përkrahjes së të Rinjve. 28
Qendra sociale "MURIALDO" 28
Shoqata "PËRTHYERJA" 28

Kreu VII. TË MITURIT NË SHËRBIMIN E PROVËS 29
Të miturit gjatë fazës së zbatimit të vendimit 29
Të miturit dhe puna në interes publik 30
Rast praktik: Puna në interes publik 31

Kreu VIII. MBIKËQYRJA ELEKTRONIKE 32
Çfarë është? 32
Kush mund të mbikëqyret elektronikisht? 32
Si funksionon? 32
Çfarë ndodh nëse shkelen kushtet? 32
Cili është përfitimi? 33

Kreu IX. SHËRBIMI I PROVËS DHE SHTETASIT E HUAJ 34

Kreu X. KOMPETENCA TOKËSORE DHE STRUKTURA E SHËRBIMIT TË PROVËS 35
Struktura aktuale 37
Trajnimi i vazhdueshëm i stafit 38

KREU XI. STATISTIKA PËRMBLEDHËSE 40

Fakte të shpejta

- Që prej fillimit të funksionimit në maj 2009 dhe deri në dhjetor 2014, Shërbimi i Provës ka mbikqyrur 13359 të dënuar të cilëve dënimi me burgim iu është zëvendësuar me një prej dënimeve alternative.
- Për vitin 2014, Shërbimi i Provës ka dërguar drejt gjykatave 446 raporte vlerësimi të rrethanave shoqërore për të dënuar me burgim të cilët kërkojnë lirim me kusht apo qëndrim në shtëpi dhe drejt prokurorive 155 raporte vlerësimi në fazën para dhënies së dënimit.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS
Rr. "Jordan Misja", pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda
Tel: +355 4 2227928
e-mail: sekretariadpshp@sherbimiproves.gov.al
Faqja zyrtare në rrjet: www.sherbimiproves.gov.al

Kontakt zyrat vendore:

ZYRA VENDORE - SHKODËR
Lagjja "3 Heronjtë", Rr. "Skënderbeg", përballë "Kolping", Kati II
Tel. + 355 22 241990
e-mail: zvshpshkoder@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – LEZHË
Lagjja "Besëlidhja", 2 kullat binjake,
Tel. -
e-mail: zvshplezhe@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – DURRËS
Lagjja Nr.1, Rr. Tregtare, pranë Portit Detar
Tel. + 355 52 229756
e-mail: zvshpdurres@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – TIRANË
Rr. "Jordan Misja", pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda
Tel. + 355 4 2232852
e-mail: zvshptirane@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – ELBASAN
Lagjja "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "11 Nëntori", pranë prefekturës
Tel. + 355 54 258901
e-mail: zvshpelbasan@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – FIER
Lagjja "Kastrioti", Rr. "Leon Rei", Godina "Ish-Qendra Ilogaritëse", Kati IV
Tel. + 355 34 23591
e-mail: zvshpfier@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – KORÇË
Bulevardi "Republika", pranë Prefekturës, Korçë
Tel. + 355 8 2257916 / 247434
e-mail: zvshpkorce@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – GJIROKASTËR
Rr. "Qafa e Pazarit", Godina e Këshillit të Qarkut, kati II, Gjirokastër
Tel. +355 84 267836
e-mail: zvshpgjirokaster@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – MAT
Lagjja "Pjetër Budi", Rr. "Kont Urani", Godina e Gjykatës së Rrethit Mat
Tel. +355 217 23537
e-mail: zvshpmat@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – KUKËS
Rruga "Drini", Godina "Ish-Shtëpia e Oficerëve", kati IV
Tel. +355 242 24507
e-mail: zvshpkukes@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – VLORË
Lagjja "10 Korriku", Rr. "Çamëria"
e-mail: zvshpvlore@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – BERAT
Bulevardi "Republika", Godina e Qarkut Berat
Tel. +355 322 34470
e-mail: zvshpberat@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – TROPOJË
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshptropoje@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – PUKË
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshppuke@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – DIBËR
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshpdiber@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – KAVAJË
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshpkavaje@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – LUSHNJE
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshplushnje@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – PËRMET
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshppermet@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – POGRADEC
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshppogradec@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – SARANDË
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshpsarande@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – KURBIN
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshpkurbin@sherbimiproves.gov.al

ZYRA VENDORE – KRUJË
Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
e-mail: zvshpkruje@sherbimiproves.gov.al

Fjalë përshëndetëse

Ilir Qafa,
Drejtor i Përgjithshëm

Aplikimi i alternativave të dënimit me burgim në vendin tonë përbën tashmë një prej modeleve të suksesit në sistemin e drejtësisë penale, duke reduktuar gjithmonë e më tepër atë që ka qenë modeli i mëparshëm, i aplikimit vetëm të dënimit me burgim. Gjatë vitit 2014 institucioni i Shërbimit të Provës është fokusuar në implementimin e praktikave dhe modeleve, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të përcaktuara në instrumentet kombetare dhe ndërkombëtare. Vetëm nëpërmjet rritjes së garancive dhe standardeve të kërkuara në fushën e alternativave të dënimit me burgim, rritet siguria e komunitetit dhe ulet përsëritja e kryerjes së veprave me natyrë penale. Përpos arritjeve, sfidat që paraqiten në përmbushjen e misionit të Shërbimit të Provës janë të shumanshme dhe për identifikimin e tyre është ideuar një përqasje e strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, e bazuar në përvojën e deritanishme dhe standardet me të larta ndërkombëtare. Njohja dhe mirëmbajtja e arritjeve të deritanishme si dhe përballimi i problematikave sipas prioriteteve të përcaktuara në mënyrë të qartë, do të jenë objekti i vazhdueshëm i veprimtarisë së Shërbimit të Provës në përmbushjen më së miri të misionit të tij.

Po gjatë vitit 2014 Shërbimi i Provës ka mbikëqyrur dhe ka punuar në mënyrë të vazhdueshme me më tepër se 6000 të dënuar në komunitet. Përgjatë vitit 2014, numri i lartë i masave alternative të aplikuara ka ndikuar si asnjëherë tjetër në lehtësimin e mbipopullimit në burgje. Ulja e përsëritjes së veprave penale dhe ulja e rrezikshmërisë së shkaktimit të dëmit ndaj publikut është vlerësuar nga ana e stafit të Shërbimit të Provës në korrelacion me menaxhimin efektiv dhe efikas të detyrimeve të vendosura në vendimet gjyqësore për të dënuarit. Stafi ynë është i angazhuar për të vendosur marrëdhënie sa më profesionale me të gjithë personat e referuar pranë Shërbimit të Provës, marrëdhënie e cila synon motivimin dhe mbështetjen e të dënuarve në ndërmarrjen e iniciativave dhe hapave që mundësojnë ndryshime pozitive në jetën e tyre.

Ky buletin informues, botim tashmë i përvitshëm falë mbështetjes së paçmueshme të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, synon të përcjellë një pasqyrë të plotë të përpjekjeve të Shërbimit të Provës në përmbushjen e detyrave funksionale dhe jo vetëm. Gjatë shfletimit të tij, të interesuarit do të mund të njihen me mënyrat dhe metodat e punës të përdorura nga Shërbimi i Provës për riintegrimin e të dënuarve në shoqëri, me objektivat kyçe dhe përshkrimin e punës së bërë në bashkëpunim me partneret tanë si gjykata, prokuroria, burgjet dhe policia e shtetit por edhe me organizatat jofitimprurëse në përpjekjen për të forcuar sigurinë e komunitetit në mënyre aktive dhe prosociale. Në përmbajtjen e tij përshkruhen fushat kryesore te veprimtarisë së Shërbimit të Provës, arritjet dhe sfidat e ardhshme në ofrimin e një shërbimi sa më të përshtatshëm në funksion të ofrimit të kontributit të tij të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë penale.

Ilir Qafa
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

KREU I – SHËRBIMI I PROVËS NË SHQIPËRI – NJË PAMJE E PËRGJITHSHME

Hyrje

Krijimi i institucionit të Shërbimit të Provës si një risi në sistemin penitenciar shqiptar, dhe puna e vazhdueshme për zhvillimin e gjithanshëm të këtij shërbimi, ka bërë të mundur, aplikimin e dënimeve alternative dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre në praktikë. Që nga fillimet e tij e deri aktualisht, Shërbimi i Provës vazhdon me intesitet procesin e aplikimit të dënimeve alternative dhe treguesit numerikë janë pozitivë.

Sot, kemi një Shërbim të Provës, i cili realizon funksionet e ngarkuara nga ligji vetëm për një periudhë kohore prej 6 vitesh, kemi një staf që ka marrë kualifikime të vazhdueshme për të realizuar sa më mirë detyrat e tij; së fundmi, kemi bërë të mundur mbulimin e plotë të territorit të Shqipërisë me hapjen e zyrave të reja vendore pranë të gjitha rretheve gjyqësore për të qenë sa më pranë publikut dhe kemi siguruar ambjente pune optimale për të gjitha zyrat vendore; kemi bazën e mjaftueshme teknike e materiale që po shkon drejt përmirësimit të kushteve të punës për stafin; kemi marrëdhënie të stabilizuara bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare më të rëndësishme BE, OSBE, UNICEF etj, të përfshira drejtpërdrejt që nga krijimi i Shërbimit të Provës, ashtu edhe të legjislacionit përkatës. Gjithashtu, kemi shtuar marrëveshjet e bashkëpunimit me pushtetin vendor, me OJF-të e specializuara në fusha të ndryshme, duke bërë të mundur zbatimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata për dënimet alternative të dhëna, si dhe rritjen e gamës se shërbimeve të specializuara, të nevojshme për aplikimin e këtyre lloj dënimeve alternative.

Gjatë vitit 2014, krahas arritjeve, Shërbimi i Provës është përballur me mjaft sfida për realizimin me sukses të detyrave të tij, duke treguar domosdoshmërinë që të vazhdohet mbështetja ndaj këtij institucioni të ri në sistemin pentenciar shqiptar.

Misioni i Shërbimit të Provës

Shërbimi i Provës në misionin e tij përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës. Shërbimi i Provës mbështet dhe inkurajon riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social. Shërbimi i Provës në kryerjen e këtij misioni udhëhiqet nga ligjshmëria, objektiviteti, respektimi i të drejtave të njeriut, mosdiskriminimi, dhe respektimi i dinjitetit.

Gjatë vitit 2014 Shërbimi i Provës ka punuar në drejtim të përmirësimit të praktikave të punës për përmbushjen e misionit te tij. Prioriteti i aktivitetit te këtij institucioni ka qene ruajtja e sigurise se komunitetit, orientimi i te denuarve drejt sjelljeve pro-shoqerore dhe ne nje nivel me te pergjithshem, dhenia e nje shërbimi ndaj publikut i cili priret nga cilësia, transparenca dhe efikasiteti.

Sfidat që paraqiten në përmbushjen e këtij misioni janë të shumanshme dhe për identifikimin e tyre është tentuar të krijohet një përqasje e strukturuar gjithëpërfshirëse, e bazuar në përvojën e deritanishme dhe në të dhënat faktike. Kjo është parë si metoda më e mirë për të identifikuar pikat e forta e të dobëta të këtij institucioni, gjë që lejon njohjen e arritjeve dhe kapitalizimin e

tyre për zhvillim të mëtejshëm, ashtu si dhe lejon edhe njohjen e problematikave, të cilat duhen adresuar sipas prioriteteve të caktuara.

Shërbimet e ofruara për institucionet dhe publikun

1 - Mbikëqyrja e dënimeve alternative, e cila synon mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale; asistimi i personit të dënuar në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegriminin e tij shoqëror.

2 - Vlerësimi i shkelësit të ligjit që ka si qëllim individualizimin e dënimeve alternative për shkelësit e ligjit nëpërmjet qartësimit të nevojave lidhur me mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetit të të dënuarit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat e kanë penguar atë të zhvillojë një jetë shoqërore normale.

3 - Mbikëqyrja elektronike, e cila synon rritjen e sigurisë publike dhe ekzekutimin efektiv te vendimeve gjyqësore për personat të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Përgjegjësitë kryesore të Shërbimit të Provës janë:

- Kontributi në procesin e individualizimit të sanksioneve dhe masave të vendosura nga organet juridike në periudhën e zhvillimit të procesit penal.
- Zbatimi i ekzekutimit të vendimeve të gjykatës, e cila u vendos personave të dënuar detyrimin për të respektuar disa masa dhe për të zbatuar disa detyrimeve.
- Mbajtja e lidhjeve të vazhdueshme me gjykatat dhe prokuroritë duke i informuar mbi mënyrën se si janë respektuar nga të dënuarit masat e caktuara dhe detyrimet e vendosura.
- Ofrimi i mbështetjes se personave të sanksionuar penalisht për të kaluar nevoja të caktuara me të cilat përballet dhe të cilat mund të çojnë në përsëritjen e veprave penale.
- Përfshirja e komunitetit në procesin e mbikëqyrjes dhe riintegrimin e personave të dënuar duke i mbajtur në periudhë prove.

Kontributi i Shërbimit të provës në përforcimin e ekzekutimit të vendimeve penale zë një vend të konsiderueshëm nv sistemin e drejtësisë penale në Shqipëri, krahas institucioneve të tjera si gjykatat, prokuroria, policia dhe burgjet. Në sajë të këtij kontributi, shumë të dënuar, kryesisht ata me rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe premisa të larta për rehabilitim, pas kryerjes së një vepre penale, janë lejuar të vuajnë dënimin alternativ pranë komunitetit të tyre.

Për më tepër, pas një vlerësimi të faktorëve, të cilet i kanë shtyrë drejt kryerjes së veprave penale, Shërbimi i Provës ka asistuar në adresimin e këtyre faktorëve, në mënyrë që të nxisë

bashkëpunimin e të dënuarve në përpjekje për të qëndruar larg krimit. Ky është një proçes i gjatë, i cili jo vetëm kërkon profesionalizëm dhe përkushtim nga ana punonjësit të Shërbimit të Provës, po aq edhe bashkëpunim nga vetë të dënuarit, ndërkohë që nga ana tjetër kërkon gjithashtu një mbështetje dhe bashkëpunim me organet shtetërore qendrore, me organet e njësive të qeverisjes vendore, me OJF të ndryshme dhe shërbime të tjera.

Alternativat e dënimit me burgim

Në kontekstin e sistemit të drejtësisë shqiptare, dënimet alternative janë prezantuar në Kodin Penal të vitit 1995, por me rishikimin e vitit 2008 u ndryshuan dhe u përmirësuan përcaktimet në lidhje me "Alternativat e dënimit me burgim", të cilat lejojnë hapësirë më të gjerë për zbatimin në praktikë të tyre, rezultat i të cilës është dhe ligjërimi i institucionit të Shërbimit të Provës i cili mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve alternative qe prej vitit 2009.

E përbashkëta e dënimeve alternative është se dënimi kryhet në ambiente jo të izoluara siç ndodh në rastin e dënimit me burgim. Dënimi me burgim është parë në të shkuarën si masa më e mirë për të rritur sigurinë e komunitetit dhe dënimin e veprimeve kriminale duke synuar uljen apo eliminimin e tyre. Megjithatë jo gjithmonë ky është rasti. Rezultatet e rehabilitimit dhe riintegrimit nëpërmjet izolimit me burgim janë të përziera, që do të thotë se jo gjithmonë ka dhënë efektin e dëshiruar, duke hapur kështu horizonte të reja e duke e zhvendosur theksin nga ndëshkimi ndëshkimi i veprës penale drejt trajtimit të autorit të saj.

Dënimet alternative janë gjithashtu një mënyrë e mirë për të bërë trajtimin e diferencuar të të dënuarve sipas grupeve të veçanta në të cilat bëjnë pjesë, si p.sh.: të miturit, gratë, të moshuarit, të sëmuret mendore, personat me varësi ndaj substancave narkotike, personat, të cilët kanë probleme shëndetësore që kërkojnë trajtim të specializuar, të dënuar që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijë të mitur, të cilët nuk mund ta kenë përndryshe kujdesin prindëror etj..

Dënimit me burgim i personave që u përkasin grupeve të mësipërme mund të sjellë pasoja që jo vetëm nuk kontribuojnë në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre, por mund të shkaktojnë dëme të parikuperueshme, që mund të kenë ndikim të kundërt.

Kutia informative 1 - Detyrimet

Gjatë periudhës së provës, në zbatim të njërit prej dënimeve alternative, të dënuarit duhet të përmbushin detyrime të parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal: 1) Të ushtrojë veprimtari profesionale ose të marrë arsimim apo formim profesional; 2) Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare; 3) Të riparojë dëmin civil të shkaktuar; 4) Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara; 5) Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari; 6) Të mos frekuentojë vende të caktuara; 7) Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike; 8) Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara; 9) Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo me bashkëpunëtorë të veprës penale; 10) Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë; 11) Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues; 12) Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

Sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor, Shërbimi i Provës merr në mbikëqyrje përmbushjen e këtyre detyrimeve duke ndërtuar programe trajtimi, të cilat përkojnë me nevojat e të dënuarit. Duke identifikuar motivet dhe shtysat për kryerjen e veprimeve kriminale, si dhe faktorët personale, familjare apo social-ekonomikë që fshihen pas tyre, bëhet e mundur që trajtimi të drejtohet drejt përmirësimit të këtyre faktorëve të identifikuar në mënyrë të posaçme.

Kutia informative 2- Shkelja e detyrimeve

Në rast se i dënuari përmbush rigorozisht detyrimet që i janë vendosur nga gjykata mund të thuhet se dënimi alternativ e ka arritur qëllimin e tij edukues duke ulur njëkohësisht dhe rrezikshmërinë shoqërore të tij, si dhe duke rritur sigurinë në komunitet.

Nëse i dënuari gjatë periudhës së provës kryen një vepër tjetër penale apo shkel detyrimet ose kushtet e caktuara nga gjykata, Shërbimi i Provës njofton prokurorin duke parashtruar dhe propozimet përkatëse. Pra, Shërbimi i Provës luan një rol kryesor në identifikimin dhe raportimin e sjelljes së të dënuarit tek prokurori.



Rritja e sigurisë së publikut

Alternativat e dënimit me burgim konsiderohen si dënime që kryen në komunitet dhe për këtë arsye ato janë konsiderohen të dobishme, pasi kombinojnë kontrollin me mbështetjen për të dënuarit, në mënyrë që ata të largohen nga rruga e krimit. Prandaj, përfitimet janë të dyfishta: si për shkelësit e ligjit, ashtu dhe për komunitetin që i përkasin.

Dënimet që kryen në komunitet nuk përbëjnë shmangie nga sistemi i drejtësisë penale. Të dënuarit me dënime alternative nuk janë tërësisht të lirë, por ata duhet të përballen me kufizime të lirisë të vendosura me vendim gjyqësor, gjatë kohës që ata ndodhen nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës.

Ulja e recidivizmit

Dënimet komunitare synojnë të ndëshkojnë, të ndryshojnë, të kontrollojnë dhe të ndihmojnë të dënuarit duke iu përshtatur nevojave të tyre. Një rrugë mjaft efektive për të ndryshuar sjelljen e personave që kryejnë veprime kriminale është përfshirja e tyre në një program trajtimi gjithëpërfshirës. Statistikat tregojnë se këto programe reduktojnë ripërfshirjen e këtyre të dënuarve në krim, pasi këto programe u ofrojnë të dënuarve mënyra se si mund të zgjidhin problemet e tyre dhe të qëndrojnë larg sjelljeve kriminale në të ardhmen.

Kush përfiton?

Dënimet komunitare nuk përbëjnë shpëtim nga sistemi i drejtësisë penale. Të dënuarit me dënime alternative nuk janë tërësisht të lirë, por ata duhet të përballen me kufizime të lirisë duke qenë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës për një afat 18 muaj deri në 5 vjet, të kryejnë punë në interes publik apo të përmbushin detyrime të tjera të vendosura nga gjykata.

- Viktima të mundshme të krimit
  Për shumë të dënuar, ndëshkimi nëpërmjet dënimeve komunitare është e provuar se është më efektiv në uljen e recidivizmit se dënimet me burgim, qofshin këto edhe afatshkurtra. Kjo nënkupton se përdorimi i dënimeve komunitare për këtë kategori të dënuarish potencialisht do të ketë më pak viktima të krimit në komunitetin tonë.
- Pushteti vendor
  Kryeja e një pune të papaguar pranë njësive të pushtetit vendor konsiston në riparimin e dëmit që i dënuari i ka shkaktuar komunitetit ku jeton. Puna e papaguar mund të kryhet në fusha të tilla si pastrim, gjelbërim, mirëmbajtje të ambienteve të përbashkëta, riparimi i parqeve dhe lulishteve. Kjo kërkon një përkushtim të madh për ta bërë komunitetin një vend më të mirë për të jetuar.
- Taksapaguesit
  Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, mbajtja e një të dënuari në burg i kushton shtetit 766 500 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë në vit. Por dënimi me burgim nuk është gjithmonë rruga më e përshtatshme për t'u aplikuar mbi personat që kryejnë vepra penale. Përsa i përket uljes së recidivizmit, dënimeve alternative janë më efektive se dënimet afatshkurtra me burgim. Gjithashtu, duhet të sigurohet që ndëshkimi të sjellë përfitime në disa fusha njëherësh, si në termat e uljes së recidivizmit dhe në mënyrën se si përdoren paratë e taksapaguesve.
- Të dënuarit
  Shkelësit e vazhdueshëm të ligjit shpesh nuk e kuptojnë efektin shkatërrues të krimeve të tyre mbi viktimat dhe ata mund të fillojnë një proces të reformimit të vetes kur janë të shtrënguar që të përballen me dëmin dhe shqetësimin që kanë shkaktuar. Të tjerëve u mungon kapaciteti i duhur për të ndihmuar vetveten dhe në momentin që ju duhet të përballen me problemet dhe kaosin në jetën e tyre mund t'i rikthehen rrugës së krimit. Për shumë të dënuar, vendosja e tyre nën programe të ndryshme mbikëqyrjeje i detyron të përballen me pasojat e krimeve të tyre dhe origjina e sjelljes së tyre kriminale është pjesa më e vështirë e ndëshkimit të tyre, e cila njëkohësisht përbën dhe pjesën më të rëndësishme.

Kuti informative 3 - Kriteret e përfitimit të dënimit alternativ?

Gjysmëliria	deri 1 vit burgim
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vënia në provë	deri 5 vjet burgim
Qëndrimi në shtëpi	deri 2 vjet burgim
Pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe puna në interes publik	deri 1 vit burgim (40-240 orë)
Lirimi me kusht	deri 5 vjet 2/3 e dënimit deri 25 vjet 3/4 e dënimit

KREU II - PARIMET DHE KONCEPTET NË THEMEL TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Veprimtaria e Shërbimit të Provës bazohet mbi parimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shërbimi i Provës siguron që në veprimtaritë e tij të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër.

Shërbimi i Provës gjatë veprimtarisë së tij respekton dinjitetin e personit nën hetim, të pandehurit dhe të dënuarit dhe përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe normave të ndërveprimit social.

Përgjegjësitë e Shërbimit të Provës

- Shërbimi i Provës jep kontribut në procesin e individualizimit të sanksioneve dhe masave të vendosura nga organet juridike në periudhën e zhvillimit të procesit penal.
- Zbaton ekzekutimet e vendimeve të gjykatës, e cila i vendos personave të sanksionuar penalisht respektimin e disa masave dhe zbatimin e disa detyrimeve.
- Mban lidhje të vazhdueshme me gjykatat dhe prokuroritë duke i informuar për mënyrën se si janë respektuar masat e caktuara dhe detyrimet e vendosura personave të sanksionuar penalisht.
- Ofron mbështetje personave të sanksionuar penalisht për të kaluar nevoja të caktuara, me të cilat përballet dhe të cilat mund të shkaktojnë përsëri vepra penale.
- Përfshin komunitetin në procesin e mbikëqyrjes dhe riintegrimit të personave të sanksionuar penalisht duke i mbajtur në periudhë prove.

Kuti informative 4 - Shërbimi i provës anëtar i CEP

CEP, Organizata Europiane për Shërbimin e Provës është themeluar në vitin 1981. Kjo Organizatë synon të nxisë përfshirjen sociale të shkelësve përmes sanksioneve dhe masave komunitare, të tilla si shërbimin e provës, shërbimet komunitare, ndërmjetësimin dhe pajtimin. CEP është e angazhuar për të rritur rolin e shërbimit të provës dhe për të përmirësuar profesionalizmin në këtë fushë, në një nivel kombëtar dhe evropian.

CEP promovon bashkëpunimin mbarë-europian me organizimin e konferencave mbi tematikat aktuale të shërbimit të provës.

Duke vënë në dispozicion raportet e këtyre eventeve, me botimin e buletinit të saj digjital dhe nëpërmjet faqes së internetit, CEP nxit shkëmbimin e ideve mbi shërbimin e provës. Në këtë mënyrë ajo përbën një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e sanksioneve dhe masave komunitare.

Anëtarët e saj janë organizata që punojnë në fushën e shërbimit të provës dhe individëve të interesuar, të cilët së bashku sjellin një rrjet unik të ekspertizës në lidhje me mënyrat pozitive

për të punuar me të dënuarit në komunitet dhe si të mbrojnë shoqërinë pa përdorur sanksione të ashpra.

Për Organizmat Evropiane si Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës CEP është zëri i sektorit për Shërbimin e Provës, duke siguruar të dhëna të specializuara dhe krahasuese, duke përbërë gjithashtu zërin e Shërbimit të Provës në Bruksel.

Që prej datës 8 tetor 2013, Shërbimi i Provës Shqiptar aderon në këtë Organizatë si anëtar me të drejta të plota, duke qëndruar në krah të 37 vendeve Evropiane, anëtare të saj. Gjatë vitit 2014, Shërbimi i Provës ka marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga kjo konfederatë, duke sjellë kështu frymën e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave mes vendeve të Evropës me qëllim përhapjen dhe implementimin e praktikave më të mira dhe efektive për mbikëqyrjen e suksesshme të të dënuarve.

Çfarë do të thotë mbikëqyrja e një rasti?

Objekti i mbikëqyrjes është identifikimi i nevojave kriminogjene dhe sociale të personave të mbikëqyrur në pamjen e vlerësimit të riskut të përsëritjes së veprës penale, monitorimi i rastit në të cilin personi i mbikëqyrur respekton masat dhe detyrimet e vendosura nga gjykata, motivimi i të mbikëqyrurit për t'u angazhuar në procesin e ndryshimit të sjelljes, zbatimin e disa sjelljeve pro-sociale dhe ruajtjen e tyre, mbështetjen në pikëpamjen e kapërcimit të nevojave të identifikuara gjatë vlerësimit me anë të përfshirjes së tij në programet e asistimit dhe të konsultimit.

Specialisti i Shërbimit të Provës bën verifikimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata për të dënuarin. Pritshmëria është që personi i dënuar të përmbushë të gjitha detyrimet e vendosura nga gjykata. Këto mund të jenë të shumëllojshme, kryesisht punë në interes publik, pjesëmarrje në aktivitete edukative apo respektim i masave të kontrollit, asistim dhe trajtim i rasteve për dezintoksikim. Në monitorimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve ligjore ekziston gjithmonë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ndërmjet specialistit përgjegjës për rastin dhe të dënuarit, pavarësisht vendit të kryerjes së detyrimit (p.sh., zyra e Shërbimit të Provës, vendi i punës ose i banimit).

Asistimi dhe konsultimi

Për realizimin e mbikëqyrjes zhvillohet punë individuale dhe në grup si p.sh., punë me të dënuarit, të cilët nuk kanë kapacitetin e duhur për të gjetur një vend pune, një banesë, nuk ndjekin dot një kurs edukativ ose nuk marrin dot formim profesional. Disa nga këto raste do të konsultohen në mënyrë që të dënuarit të gjejnë motivimin e duhur dhe të mësojnë të respektojnë normat sociale. Për sa i përket punës me të dënuarit që kanë varësi ndaj drogës, Shërbimi i Provës zhvillon aktivitete të vlerësimit të natyrës së varësisë, si në fazën e përgatitjes së raportit të vlerësimit, po ashtu dhe në rastin e mbikëqyrjes. Asistimi dhe konsultimi i personave të mbikëqyrur nuk mund të realizohet veçse me kërkesën e tyre. Këto aktivitete janë në dispozicion si në rastin e vuajtjes së dënimit në komunitet, ashtu dhe në rastin e personave që vuajnë dënimin në një institucion.

Vlerësimi

Vlerësimi i rrezikut të recidivizmit është një proces i vazhdueshëm, i cili përfshin zhvillimin e parashikimeve për mundësinë e sjelljeve kriminale, frekuencën e këtyre ngjarjeve, llojet e sjelljeve dhe viktimat e mundshme të këtyre sjelljeve. Për të vlerësuar rrezikun e recidivizmit, specialisti i Shërbimit të Provës përdor informacione të lidhura me mjedisin social të personit, historinë e jetës, historikun e sjelljes para dhe pas kryerjes së veprës penale, sjelljen e përgjithshme, si dhe faktorëve të tjerë.

Për të garantuar një përqasje sa më objektive ndaj vlerësimit të të dënuarve, Shërbimi i Provës ka zbatuar, gjatë të gjitha fazave të punës me to, instrumente, të cilat mbështeten ne te dhena nga studimet kërkimore bashkëkohore dhe përvojat e vendeve më praktike të stabilizuar. Këto instrumente japin kontributin e tyre në rritjen e objektivitetit të punonjësit të shërbimit të provës dhe rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë nga ana e institucioneve bashkëpunuese me shërbimin e ofruar. Gjithashtu, këto instrumente mundësojnë ofrimin e një cilësie shërbimi të unifikuar në të gjitha degët rajonale të Shërbimit të Provës.

Trajtimi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës në lidhje me pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë. Në këtë program përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit, masat dhe detyrimet e vendosura nga gjykata dhe mënyrat e përdorura për të siguruar përmbushjen e tyre, nevojat kriminogjene, sociale dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre, rrezikun e përsëritjes së veprës penale, rrezikun e cenimit të sigurisë publike dhe atë të vetëvrasjes apo vetëdëmtimit. Gjithashtu, aty përcaktohen edhe metodat e propozuara të ndërhyrjes për të plotësuar nevojat e identifikuara dhe për të reduktuar rrezikun, si dhe data, vendi dhe frekuencat e takimeve.

I dënuari është i rëndësishëm

Shërbimi i Provës ka si synim përmbushjen e nevojave të të dënuarve sipas përcaktimeve të vendimit gjyqësor. Përveç mbikëqyrjes kontrolluese, që siguron respektimin e ligjeve dhe normave të komunitetit, të dënuarit i jepet mundësia dhe mbështetja për të nisur procesin e ndryshimit dhe shmangien e sjelljeve të mëtejshme kriminale. Shërbimi i ofruar është kompleks dhe gjithëpërfshirës, duke pasur në konsideratë nevojat e ndryshme që mund të kenë të dënuarit, të cilët bëhen pjesë e një programi të ofruar nga Shërbimi i Provës.

Rast praktik - Pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në periudhë prove (Neni 59)

Klausi ka qenë në drejtim të makinës së tij ku ndodheshin dhe dy persona të tjerë, kur ka humbur kontrollin e timonit duke rezultuar kështu në daljen e makinës nga rruga dhe kryerjen e një aksidenti rrugor. Ai, së bashku me dy personat e tjerë, kanë mbetur të dëmtuar nga aksidenti. Ndërkohë, gjatë konstatimeve të rastit, në automjet janë gjetur dhe disa armë pa leje. Rrjedhimisht, Klausi është dënuar me 5 vite heqje lirie për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe mbajtjes pa leje të

armëve, dënim, i cili është pezulluar duke qenë se gjykata e ka vendosur në periudhe prove për një periudhë 4-vjeçare.

Klausi shprehet se është penduar për kryerjen e veprave penale duke vendosur kështu bazën e parë të bashkëpunimit me punonjësin e Shërbimit të Provës. Është babai i dy fëmijëve të mitur. I dënuari aktualisht është i papunë edhe për shkak të dëmtimeve të pësuara nga aksidenti në të cilin është përfshirë e ka të vështirë të punojë. Ndërkohë, ai vazhdon studimet e larta me kohë të pjesshme.

Gjatë periudhës së provës, Klausi ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me specialistin mbikëqyrës. Gjatë këtyre takimeve është marrë informacion mbi rrethanat sociale dhe familjare, është bërë informimi i vazhdueshëm rreth të drejtave dhe detyrimeve gjatë periudhës së provës, është bërë monitorimi i sjelljeve dhe qëndrimeve të tij, është bërë konsultimi rreth vështirësive dhe problematikave të ndryshme si dhe asistimi në kapërcimin e tyre.

Veçanërisht me këtë të dënuar është punuar në lidhje me monitorimin e ecurisë së tij për të mos kryer vepra të mëtejshme penale si dhe për të mos u shoqëruar me persona me precedentë penalë. Gjithashtu, Klausi është mbështetur në nismën e tij për të kryer studime të larta, të cilat do të rrisnin mundësinë e punësimit të tij dhe lehtësimin e problemeve financiare të familjes së tij. Kjo ndikon në largimin e Klausit nga aktivitetet me natyrë kriminale.

Ai ka përmbushur detyrimet dhe kushtet që ka vendosur Gjykata duke përfunduar dënimin alternativ me sukses.

KREU III - VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË

Shërbimi i Provës në vlerësimin e rrezikshmërisë për personat e rritur, të cilët janë dënuar me një nga alternativat e dënimit me burgim, si dhe për personat e rritur për të cilët kërkohet një raport vlerësimi nga gjykatat apo prokuroritë, përdor një vlerësim sistematik, të rëndësishëm, duke mundësuar në këtë mënyrë profilizimin e të dënuarit, për të realizuar evidentimin e fushave ku duhet të ndërhyjë Shërbimi i Provës.

Vëmendje e veçantë i kushtohet edhe vlerësimit të të dënuarve të rinj. Gjatë vitit 2014, falë mbështetjes dhe ekspertizës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe ekspertizës së Shërbimit të Provës, është hartuar për të miturit dhe të rinjtë në moshe madhore një instrument i posaçëm vlerësimi.

Këto instrumente përdoren nga specialisti i Shërbimit të Provës si sisteme të unifikuara për të analizuar rrethanat sociale që lidhen me personin nën hetim, të pandehurin apo të dënuarin, nëpërmjet të cilit vlerësohet personaliteti i tij, duke evidentuar faktorët që kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale, si dhe fushat ku duhet të ndërhyhet me qëllim riintegrimin shoqëror të të dënuarve. Këto instrumente janë hartuar duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, VKM nr. 302/2009, dhe garanton parimin e ligjshmërisë dhe parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Rezultati që përftohet prej tyre përdoret nga specialisti për dhënien e rekomandimeve për gjykatën/ prokurorinë, për personat për të cilët është kërkuar një raport vlerësimi, si dhe për hartimin e Programit Individual të Trajtimit për të dënuarit nën mbikëqyrje.

Ajo çfarë është e rëndësishme të vlerësohet dhe përftohet nga këto instrumente përfshijnë:

- Vlerësimin e mundësisë për ri-kryerjen e një vepre tjetër penale
- Identifikimin dhe klasifikimin e nevojave lidhur me veprën penale
- Vlerësimin e rrezikut për dëmtime të rënda, rrezikun për vetëdëmtim ose rreziqe të tjera si:
  - t'u shkaktojë të tjerëve dëmtime të rënda
  - t'u shkaktojë dëme të burgosurve ose stafit
  - të përbëjë rrezik për arratisje / për vjedhje, kontroll ose shkelje besimi
  - të jetë në rrezik për shkak të dobësisë së vet
- Asistimin në menaxhimin e rrezikut të dëmtimit
- Lidhjen e vlerësimit me planin e menaxhimit të rrezikshmërisë
- Identifikimin e nevojës për vlerësime të tjera më të specifikuara
- Matja objektive e ndryshimit te arritur gjatë periudhës së dënimit alternativ.

Në përputhje më këto qëllime, këto mjete vlerësimi paraqesin rëndësi të veçantë për specialistët që e praktikojnë, për menaxherët, si dhe për kërkuesit shkencor. Për personat që e praktikojnë

këto instrumente kanë si qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së vlerësimit të tyre me planin e mbikëqyrjes. Përfundimi që arrihet është i detyrueshëm për t'u përdorur në dhënien e rekomandimeve për prokurorinë/ gjykatën në lidhje me personat nën hetim/të pandehur, për të cilët është kërkuar një raport vlerësimi, si dhe për të dënuarit nën mbikëqyrje, për të cilët ndërtohet Programi Individual i Trajtimit.

Dobishmëria e instrumenteve të standardizuara është:

a) të japë prova për të mbështetur vendimet se si menaxhohet risku dhe nevojat, b) identifikimi i faktorëve dinamikë të riskut që duhet të adresohen për të reduktuar përsëritjen, c) të ndihmojë specialistët të mendojnë për të dënuarin brenda një konteksti, pse kryejnë vepra penale, sa të motivuar janë ata për të ndryshuar dhe pengesat për t'u angazhuar.

Për menaxherët, të dhënat e sistematizuara mund të përdoren për planifikimin e burimeve për vlerësimin në mënyrë efikase të metodave të ndërhyrjes. Për kërkuesit shkencorë, shqyrtimi i një numri të madh të dhënash të standardizuara, sasiore dhe cilësore bëjnë të mundur krijimin e një sërë pyetjesh, të cilat duhet të eksplorohen në nivel lokal dhe kombëtar.

KREU IV - SHËRBIMI I PROVËS GJATË FAZAVE TË PROCEDIMIT PENAL

Shërbimi i Provës paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës si dhe ndihmon në ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim siç ilustrohet në tabelën vijuese.

	Faza para gjykimit	Faza gjatë gjykimit dhe zbatimi i vendimit	Faza pas përfundimit të alternativës së dënimit
Hartimi i raporteve të vlerësimit për prokurorin gjatë fazës së hetimit	√		
Hartimi i raporteve të vlerësimit për prokurorin kur ai ka dërguar pretencën në gjykatë	√		
Hartimi i raporteve të vlerësimit për gjykatën		√	
Mbikëqyrje/asistencë për të dënuarit që u pezullohet dënimi me burgim dhe vënia në provë		√	
Mbikëqyrje/organizim i shërbimit komunitar		√	
Ndërmjetësimi për zgjidhjen e konflikteve i pandehur/i dënuar- viktimë		√	
Mbikëqyrje e programeve të trajtimit të përdoruesve të drogës/alkoolit		√	
Mbikëqyrje/asistencë për të liruarin me kusht		√	
Mbikëqyrje/asistencë për të dënuarit me qëndrim në shtëpi		√	
Mbikëqyrje e detyrimeve të tjera të dhëna nga gjykata		√	
Organizim/mbikëqyrje për të dënuarit me gjysmëliri		√	
Hartimi i raporteve të mospërmbushjes për prokurorin		√	

Hapat e procedurës standarde për “lirimin me kusht”

I dënuari me burgim, në përputhje me Nenin 64 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Kërkesa shqyrtohet nga një gjyqtar, i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim.

Hapi I – Përmbushja e kushteve ligjore

I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se 2/3 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në 5 vjet burgim;
- jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga 5 gjer në 25 vjet burgim;
- dhe të mos jetë përsëritës për krime të kryera me dashje.

Hapi II – Dosja e të dënuarit

Institucionit ku i dënuari vuan dënimin paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport. Në raport përcaktohen: natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi III – Kërkesa e gjykatës për raport vlerësimi

Gjykata i kërkon Shërbimit të Provës të paraqesë një raport vlerësimi për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit.

Hapi IV – Përgatitja e raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës përgatit raportin bazuar në dy a më shumë takime me personin, kontakton anëtarët e familjes, si dhe çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth arsimit, punësimit, strehimit, sjelljes, shëndetit, rrethanave shoqërore dhe familjare.

Në raport përcaktohen: natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi V – Dorëzimi i raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës dorëzon raportin e vlerësimit përpara gjykatës me rekomandimin përkatës.

Hapi VI - Vendimi i gjykatës

Kur gjykata vendos lirimin me kusht të personit, i dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku do të jetojë i dënuari pas lirimit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.

Hapi VII – Urdhri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës

Prokuroria nxjerr urdhrin e ekzekutimit për zbatim nga Shërbimi i Provës.

Hapi VIII – Mbikëqyrja e personit të liruar me kusht

Shërbimit i Provës kontakton rregullisht personin e liruar me kusht duke mbikëqyrur përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në urdhrin e ekzekutimit dhënë sipas vendimin të gjykatës. Shërbimi i Provës harton dhe ndjek zbatimin e programit individual të trajtimit duke asistuar dhe këshilluar personin e liruar me kusht (të dënuarin) për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe ato të Policisë së Shtetit për mbikëqyrjen e të dënuarve.

Shërbimi i Provës mund t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht, kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato ose në rast shkeljesh të detyrimeve dhe kushteve nga i dënuari, mund t'i kërkojë revokimin e vendimit të lirimit me kusht. (Raport mospërmbushjeje detyrimesh). Gjatë kohës së provës, i dënuari është i detyruar:
a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi Shërbimin e Provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata.
b) të marrë pëlqimin nga Shërbimi i Provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit.

Hapi IX – Raporti përfundimtar

Raporti përfundimtar për përfundimin e plotë të mbikëqyrjes së periudhës së provës përgatitet nga specialisti mbikëqyrës, miratohet nga drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës dhe i dërgohet prokurorit që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit. Gjithashtu, vihet në dijeni Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse. Ky raport përmban në mënyrë të përmbledhur ecurinë e periudhës së mbikëqyrjes dhe masën në të cilën janë përmbushur detyrimet e përcaktuara nga gjykata, si dhe përfshin rekomandimet përkatëse. Prokuroria, bazuar në sa më sipër, njofton gjykatën dhe shpall përfundimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

Rast praktik - Lirimi me kusht

Saimiri, që prej 5 vitesh vuan dënimin me burgim pasi është shpallur fajtor nga gjykata për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve", në bashkëpunim. Prej dënimit atij i ka mbetur për të kryer edhe dy vite.
Gjatë periudhës së lirimit me kusht prej 2 vitesh ai nuk duhet të kryejë asnjë vepër penale. Për këtë qëllim, gjykata i ka caktuar, gjithashtu, detyrimin që të mos shoqërohet me persona me precedentë penalë, kryesisht të dënuar me këtë vepër penale.

Puna e Shërbimit të Provës ka konsistuar në mbikëqyrjen dhe mbështetjen e mbarëvajtjes se riintegrimit në shoqëri të Saimirit. Shërbimi i provës ka monitoruar mbarëvajtjen e tij në punë, në familje, si dhe personat me të cilët ai kalon kohën e lirë. Saimiri e pranon veprën penale dhe mban një qëndrim kritik ndaj saj. Ai shprehet se gjendja e dobët ekonomike e ka detyruar që të përfshihet në veprime të kundërligjshme. Saimiri paraqitet natyrë e qetë, i sjellshëm dhe i komunikueshëm. Ai rrjedh nga një familje e thjeshtë punëtore dhe nuk ka probleme në komunitetin ku jeton. Ka nën kujdesin e tij 2 fëmijë të mitur dhe shprehet se në të ardhmen do të merret me edukimin e tyre. Ai ka gjetur një punë si shitës në një dyqan ushqimor.

Në përfundim të periudhës seë provës ka rezultuar se Saimiri gjatë kryerjes së dënimit alternativ "Lirim me kusht" nuk ka kryer vepër tjetër penale.Ndërkohë, ka punuar për përmirësimin e kushteve të tij sociale si dhe njëkohësisht të përkujdeset për familjen e tij.

Hapat e procedurës standarde për "qëndrimin në shtëpi"

Hapi I - Përmbushja e kushteve ligjore

Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.

b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.

c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.

ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.

d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare.

Hapi II – Dosja e të dënuarit (në rastin kur "Qëndrimi në shtëpi jepet si pjesë e mbetur e dënimit)

Institucioni, ku i dënuari vuan dënimin, paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport. Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi III – Kërkesa e gjykatës për raport vlerësimi

Gjykata i kërkon Shërbimit të Provës të paraqesë një raport vlerësimi për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas dhënies së dënimit alternativ "Qëndrim në shtëpi".

Hapi IV – Përgatitja e raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës përgatit raportin bazuar në dy a më shumë takime me personin, kontakton anëtarët e familjes, si dhe çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth arsimimit, punësimit, strehimit, shëndetit, rrethanave familjare.

Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Hapi V – Dorëzimi i raportit të vlerësimit

Shërbimi i Provës dorëzon raportin e vlerësimit përpara gjykatës me rekomandimin përkatës.

Hapi VI -Vendimi i gjykatës

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me "Qëndrim në shtëpi" të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi. Në këtë rast, gjykata përcakton detyrimet që duhet të mbikëqyrë Shërbimi i Provës. Gjykata dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku jeton i dënuari dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal në rastin e

lirimit nga burgu.

Hapi VII – Urdhri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës

Prokuroria nxjerr urdhrin e ekzekutimit për zbatim nga Shërbimi i Provës.

Hapi VIII – Mbikëqyrja e dënimit alternativ

Mbikëqyrja e personit të dënuar me "Qëndrim në shtëpi" duhet të kryhet rregullisht nga Shërbimi i Provës, duke rënë dakord dhe duke firmosur programin individual të trajtimit. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës njofton organet vendore të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunon me organet e pushtetit vendor. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës zbatohet raport mospërmbushjeje dhe gjykata revokon "Qëndrimin në shtëpi", duke e zëvendësuar atë me një dënim tjetër.

Hapi IX - Raporti përfundimtar

Raporti përfundimtar për përfundimin e plotë të mbikëqyrjes së personit të dënuar me "Qëndrim në shtëpi" përgatitet nga specialisti mbikëqyrës, miratohet nga drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës dhe i dërgohet prokurorit i cili ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, si dhe vihen në dijeni Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës dhe drejtuesi i prokurorisë përkatëse. Ky raport përmban në mënyrë të përmbledhur ecurinë e periudhës së mbikëqyrjes dhe masën në të cilën janë përmbushur detyrimet e përcaktuara nga gjykata, si dhe përfshin rekomandimet përkatëse. Prokuroria, bazuar në sa më sipër, njofton gjykatën dhe shpall përfundimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

Rast praktik - Qëndrim në shtëpi

Pas një periudhe të turbullt në marrëdhëniet e saj personale, e ndjerë e lënduar, Mirela ka kundërvepruar duke shantazhuar për t'u hakmarrë ndaj personave që i kanë shkaktuar këtë lëndim. Pas raportimit nga personat e cenuar, Mirela është dënuar nga gjykata me akuzën e "Shtrëngimit me anë të kanosjes për dhënien e pasurisë" me një periudhë burgimi prej 8 muajsh, periudhë e cila sipas përcaktimeve të Nenit 59/a te Kodit penal është zëvendësuar me 8 muaj "Qëndrim në Shtëpi", kohë gjatë së cilës ajo është mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës.

Gjatë takimeve me specialistin e shërbimit të provës, Mirela shprehet se ndjehet thellësisht e penduar dhe se këto veprime mund të ishin shmangur dhe se mosha e saj e re ka ndikuar në mos-kontrollimin e sjelljeve impulsive, të cilat i ka kryer në dëm të palës së dëmtuar.

Ajo jeton aktualisht me 2 prindërit e saj, dhe është nxënëse në shkollë të mesme me sistemin me kohë të pjesshme.

Ndër hapat e parë të punës së shërbimit të provës me të dënuarën, ka qenë nisja e një procesi ndërmjetësimi për të shuar konfliktet me palën e dëmtuar, të cilat mund të përbëjnë shkak për nxitje të problemeve të mëtejshme. Gjithashtu, Mirela është angazhuar që gjatë kësaj periudhe t'i përkushtohet studimit dhe përmirësimit të rezultateve shkollore. Gjatë periudhës 8-mujore të dënimit "Qëndrim në shtëpi" ka rezultuar se ecuria e riintegrimit të Mirelës në shoqëri ka qenë e suksesshme.

KREU V - BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA

Për sa i përket bashkëpunimit me institucionet e tjera, bashkëpunimi i zyrave vendore të Shërbimit të Provës me organet e pushtetit qendror, pushtetit vendor dhe Policinë e Shtetit, ka vazhduar normalisht sipas marrëveshjeve të lidhura me to për trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes për të dënuarit me dënime alternative. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve me njësitë e qeverisjes vendore është sigurimi prej tyre i vendeve të punës për personat me banim në komunitetin e tyre, për të cilët, gjykata ka dhënë si masë alternative punën me interes publik. Bashkëpunim ka pasur edhe për rastet e të dënuarve me dënime të tjera alternative, për të cilat pushteti vendor është drejtpërdrejt i interesuar me qëllim garantimin e sigurisë publike të komunitetit, riintegrimin në shoqëri të personit të dënuar, që është anëtar i atij komuniteti, si dhe dhënien e ndihmës për të dënuarit për t'u riintegruar në komunitet.

Organet e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor

Shërbimi i Provës bashkëpunon me pushtetin lokal për të mbështetur të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata. Për realizimin e bashkëpunimit, Shërbimi i Provës ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi, ku thelbi i tyre është sigurimi i vendit të punës për personat me vendbanim në komunitetin e tyre, për të cilët gjykata ka dhënë si masë alternative punën me interes publik. Bashkëpunim është parashikuar edhe për rastet e të dënuarve me dënime të tjera alternative, për të cilat pushteti vendor është drejtpërdrejt i interesuar me qëllim garantimin e sigurisë publike të komunitetit, me qëllim riintegrimin në shoqëri të personit të dënuar që është anëtar i atij komuniteti dhe me qëllim dhënien e ndihmës për të dënuarit për t'u riintegruar në komunitet.

Janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi midis Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore duke përfshirë këshilla qarqesh, bashki dhe komuna. Ndërkohë, vazhdon puna dhe korrespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashki dhe komuna të tjera.

Nga Shërbimi i Provës janë zhvilluar trajnime me punonjësit socialë të pushtetit vendor për të mundësuar qartësimin e rolit që ata kanë në lidhje me të dënuarit që përfitojnë nga dënimet alternative. Punonjësi i Shërbimit të Provës, në bashkëpunim me punonjësin social, pasi cakton punën që duhet të kryejë i dënuari, e cila mund të jetë kryerja e një pune në interes publik. Gjithashut, ata realizojnë mbështetjen e të dënuarit në të gjitha fazat e periudhës së provës dhe në përfundim i japin të dënuarin një vërtetim për kryerjen e punës. Përsa u përket alternativave të tjera të dënimeve me burgim, bashkëpunimi me pushtetin vendor shtrihet në fushat e punësimit, strehimit, shkëmbimit të informacionit etj.
Punonjësit socialë shpesh punojnë me komunitetin dhe koordinojnë një sistem mbështetës për të dënuarin pas lirimit nga burgu:

- Gjetjen e një pune,
- Sigurimin e ushqimit,
- Strehimit,
- Veshjes,
- Transportit,
- Vendosja e lidhjeve me të tjerët,

- ❑ Ofrojnë këshillim për çështje si:
- Shëndeti,
- Përgjegjësitë prindërore,
- Vetëvlerësimi,
- Abuzimi me substanca,
- Dhuna në familje,
- Ribashkimi i familjes.

Kuti informative 5 - Funksioni i komunitetit në shoqëri.

Roli i komunitetit në ndihmë të drejtësisë penale dhe të Shërbimit të Provës, rrjedh nga vetë funksionet e komunitetit:
Shoqërizimi: Të krijojë lidhjet me të tjerët dhe të njohë individin, grupin me rregullat konvencionale të pranuara në komunitet. Shoqërizimi ndodh në familje, shkollë dhe nga media.
Kontrolli social: Të ushtrojë kontroll social ndaj individëve, grupeve që thyejnë rregullat e pranuara nga të gjithë, përfshirë gjykimin dhe dënimin e tyre.
Pjesëmarrja sociale: Të ushtrojë pjesëmarrje në diskutimin e çështjeve që e shqetësojnë dhe në vendimmarrjen për to.
Mbështetja e përbashkët: Të ofrojë mbështetje për individët, familjet, grupet që ndodhen në kushte të vështira ose përballen me vështirësi të ndryshme.

Komuniteti është shumë i rëndësishëm për ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim në këto drejtime:

Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikshmërisë dhe dëmit

- Jep informacion për të dënuarin,
- Krijon dhe zbaton skema zhdëmtimi për viktimat.

Zvogëlimi i mundësisë së ri-përfshirjes në krim

- Ofrimi i programeve terapeutike për të dënuarit në komunitet
- Mbështetja me shërbime si:
- akomodimi,
- ndihma ekonomike,
- ushtrimi i kontrollit,
- udhëheqje,
- mbështetja e të dënuarve nëpërmjet organizatave ose vullnetarëve

Mbrojtja e publikut

- Bashkëpunimi me policinë, prokurorinë, gjykatën
- Ngritja e programeve parandaluese në komunitet
- Pjesëmarrja e komunitetit në diskutimin e çështjeve të sigurisë dhe drejtësisë

Drejtoria e Përgjitshme e Burgjeve

Marrëveshja e Bashkëpunimit midis midis dy institucioneve u nënshkrua në dhjetor 2014 dhe synon ndihmën ndaj të dënuarëve për kalimin e suksesshëm nga jeta në burg në jetën në komunitet, për mbikqyrjen, respektimin e kushteve dhe ndjekjen e rasteve të personave që përfitojnë nga lirimi me kusht, rritjen e ndërgjegjësimit të të dënuarve për të përfituar nga dënimet alternative, si dhe përcaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen nga specialisti i Shërbimit të Provës me të dënuarit në I.E.V.P.

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit

Për bashkëpunimin ndërinstitucional mes Shërbimit të Provës dhe Policisë së Shtetit është nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi, e cila është mjaft e rëndësishme në funksionimin e Shërbimit të Provës, për të bërë të mundur zbatimin e detyrimeve të vendosura nga gjykata. Theksojmë se ky bashkëpunim ndërmjet zyrave vendore me komisariatet dhe drejtoritë e policisë në qarqe ka qenë mjaft i mirë dhe frytdhënës, sidomos për gjetjen dhe njoftimin e personave, për të cilët nuk ka pasur adresa të sakta në urdhrat e ekzekutimit.

Drejtoritë Arsimore Rajonale.

Gjatë vitit 2014 me disa Drejtori Arsimore Rajonal janë realizuar Marrëveshje Bashkëpunimi në interes të trajtimit sa më human dhe në interes të të dënuarëve me dënime alternative që janë të mitur dhe në proces arsimimi, si dhe të një bashkëpunimi sa më të mirë midis specialistëve të shërbimit të provës dhe psikologëve në shkolla.

Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Korçë,

Objekti i kësaj marrëveshjeje është:

- Realizimi i mbikëqyrjes të të dënuarve me dënime alternative minoren që janë nxënës,
- Organizimit të përbashkët të kurseve specifike, trajnimeve, leksioneve të hapura apo seminareve në lidhje me tematika që kanë interes studimor ose praktik, duke respektuar së pari vullnetin e të dënuarve me dënime alternative.
- Organizimit të programeve psiko-sociale (në varësi të nevojave konkrete kriminogjene të të dënuarve), të organizuara këto në grupe apo individualisht nëpërmjet kombinimit të këshillimit psiko-social me atë social dhe ligjor.
- Organizimit të aktiviteteve dhe programeve të ndryshme këshillimore, edukuese, mësimore, kulturore e sociale, me qëllim menaxhimin e sjelljeve antisociale.
- Organizimit të programeve të trajnimit profesional në raste specifike .
- Përcaktimit të fushave kërkimore, me qëllim integrimin midis strukturave për aktivitetin didaktiko-teoriko-praktik, të zhvilluar në mbështetje të kurseve të ndryshme.

KREU VI - RRJETI BASHKËPUNUES PËR TRAJTIMIN E NEVOJAVE TË TË DËNUARIT

Shërbimi i Provës ndihmon dhe mbështet të dënuarit që kanë probleme me drogën/alkoolin, ndërhyn duke ndërmjetësuar në zgjidhjen e konfliktit i dënuar-viktimë e veprës penale, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera për ushtrimin e funksioneve dhe veprimtarive të saj. Për të bërë të mundur realizimin e mbikëqyrjes për trajtimin e nevojave specifike, Shërbimi i Provës bashkëpunon me organizma, të cilat i ofrojnë këto shërbime dhe kanë përvojë në trajtimin e tyre.

Aksion +

Memorandumi i bashkëpunimit me **Aksion +** është nënshkruar më datë 23.03.2010. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.

Objekti i bashkëpunimit:
* mbështetje psiko-sociale;
* Këshillim dhe trajtim me anën e sensibilizimit dhe marrjes së masave për parandalimin e substancave narkotike dhe psikotrope, të ofruar nga psikologët e qendrës me programe terapeutike apo të kujdesit;
* Ndihmë në riintegrimin social dhe në përmbushjen e nevojave shoqërore dhe trajtimit të personave të dënuar, përdorues të lëndëve narkotike.

Komuniteti Emanuel

Memorandumi i bashkëpunimit me **Komunitetin Emanuel** është nënshkruar më datë 02.03.2011. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.

Objekti i bashkëpunimit:
* Dëgjim dhe këshillim për të rinjtë dhe familjet;
* Grupet e terapisë për trajtimin e varësisë ndaj drogave;
* Pritje gjysmë-rezidenciale për personat me varësi ndaj drogave;
* Aktivitete me natyrë parandaluese të përdorimit të drogave;
* Qendër rezidenciale për personat me varësi të lartë ndaj drogave;
* Formim profesional.

Fondacioni "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" (FZKPM)

Memorandumi i bashkëpunimit me Fondacionin "Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve" (FZKPM) është nënshkruar më datë 25.03.2010.

Objekti i bashkëpunimit:
* Ofrim i shërbimit të ndërmjetësimit dhe të drejtësisë restauruese;
* Organizim i veprimtarive me natyrë promovuese, ndërgjegjësuese dhe trajnuese në fushën e drejtësisë restauruese dhe të shërbimit të ndërmjetësimit;
* Synim për të ndikuar në grupmoshat rinore dhe në grupet e tjera sociale të shoqërisë shqiptare në promovimin dhe edukimin me vlerat e mirëkuptimit, menaxhimit konstruktiv të konflikteve, ndërmjetësimit, pajtimit dhe të tolerancës.

Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI)

Memorandumi i bashkëpunimit me **Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI)** është nënshkruar më datë 30.03.2010. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.
Objekti i bashkëpunimit:
* Mbikëqyrje e dënimit në komunitet, duke ofruar mbikëqyrje për ekzekutimin e rasteve për të mitur, si dhe mbështetje psikologjike për ta.

Aktiviteti i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) (Tirana Legal Aid Society)

Memorandumi i bashkëpunimit me Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) (Tirana Legal Aid Society) është nënshkruar më datë 23.04.2010. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.

Objekti i bashkëpunimit:
* Ofrim i mbështetjes ligjore dhe psikologjike për të dënuarit.

Qendra Komunitare multifunksionale Gjirokastër

Memorandumi i bashkëpunimit me këtë Qendër është nënshkruar më datë 24.05.2012. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.

Objekti i bashkëpunimit:
* Ofrimi i programeve këshillimore për menaxhimin e sjelljeve antisociale dhe të dhunës, këshillim psikologjik, trajtim ushqimor, akomodim, trajnime profesionale, edukim individual apo në grup.

"ARSIS" Organizata Shoqërore e Përkrahjes së të Rinjve.

Memorandumi i bashkëpunimit me këtë Qendër është nënshkruar më datë 24.05.2013. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.

Objekti i bashkëpunimit:
* Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve duke ofruar shërbime multi-disiplinare për fëmijë të gjendur në vështirësi, viktima të trafikimit, shfrytëzimit, keqtrajtimit, abuzimit dhe të çdo trajte tjetër të nëpërkëmbjes së të drejtave të tyre.
* Parandalimin e mënjanimit shoqëror të të rinjve ndërmjet përgatitjes dhe ofrimit të Shërbimeve të përkrahjes së shumanshme për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.
* Shërbim i mbështetjes, mbrojtjes dhe forcimit të fëmijëve dhe të të rinjve që në jetën e tyre kanë përjetuar vështirësi të rënda, izolim, emigrim, konflikt, refuzim, shfrytëzim etj.

Qendra sociale "MURIALDO"

Memorandumi i bashkëpunimit me këtë **Qendër** është nënshkruar më datë 25.02.2011. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.

Objekti i bashkëpunimit:
* Nxitja e formimit profesional duke ofruar kushte të ndryshme profesionale, si dhe veprimtari me karakter edukativ, sportiv, kulturor dhe artistik.

Shoqata "PËRTHYERJA"

Memorandumi i bashkëpunimit me këtë **Qendër** është nënshkruar më datë 09.03.2011. Ky bashkëpunim vazhdon aktualisht.

Objekti i bashkëpunimit:
* Program këshillimor për menaxhimin e zemërimit.

KREU VII - TË MITURIT NË SHËRBIMIN E PROVËS

Personat në fokus të ndërhyrjes në Shërbimin e Provës janë edhe të miturit që kanë kryer një vepër penale ose janë persona nën hetim/të pandehur. Gjithsej nga ana e Institucionit të Shërbimit të Provës janë trajtuar **1481** të mitur, të vendosur në njërën prej alternativave të dënimit me burgim.
Specialistët e Shërbimit të Provës hartojnë raporte vlerësimi për të miturit gjatë fazës së hetimit për prokurorin dhe raporte vlerësimi për gjykatën gjatë fazës së gjykimit dhe zbatimit të vendimit. Qëllimi i raportit është ardhja në ndihmë e prokurorit/ gjykatës që të marrë një vendim sa më të drejtë dhe të arsyeshëm për këtë të mitur. Mendimi që specialisti jep në raportin e tij duhet të shprehet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit. Ky mendim duhet të balancojë interesat më të mira për të miturit, me interesat më të mira për viktimën dhe komunitetin.
Për të bërë të mundur hartimin e raportit të vlerësimit, specialisti i Shërbimit të Provës duhet të kontaktojë me:

- Të miturin dhe të marrë informacionin e nevojshëm
- Me anëtarë të familjes
- Me persona nga shkolla apo vendi i punës
- Çdo person tjetër që mund të ofrojë informacion të dobishëm për hartimin e raportit të vlerësimit.

Të miturit gjatë fazës së zbatimit të vendimit.

Programi Individual i Trajtimit hartohet duke marrë parasysh moshën, interesin më të lartë të fëmijës, nevojat psiko-sociale, duke u konsultuar me prindërit, kujdestarin, mbrojtësin ose persona të tjerë, të kërkuar nga i mituri.

Të miturit në mbikëqyrje janë përfshirë edhe në programin për sjelljen kriminale “Ndalo – Mendo- Ndrysho”. Ky program trajton një sërë mangësish njohëse që janë të përbashkëta tek të dënuarit/të miturit. Ky program ka për qëllim që jo vetëm t’u japë të miturve mundësinë për të kuptuar sistemet e sjelljes së vet kriminale dhe problemet që lidhen me to, por edhe të zhvillojnë aftësi për të zgjidhur probleme dhe të hartojnë strategji që të shmanget sjellja kriminale në të ardhmen.

Vëmendje e veçantë u është kushtuar të miturve që kanë pasur vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të caktuara në përputhje me vendimin e gjykatës. Puna me këta të mitur është fokusuar në ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e kryerjes së dënimit si dhe me njohjen e pasojave të moskryerjes së tij.

Një faktor shumë i rëndësishëm në kryerjen me sukses të dënimit alternativ është edhe kryerja e kontaktit me familjet e të miturve, pasi familjet ndihmojnë në monitorimin dhe ndërgjegjësimin e të miturit edhe gjatë kohës kur i mituri ndodhet në ambientin familjar.

Shërbimet e ofruara për familjet e të miturve:

Vendosjen e kontaktit të parë dhe krijimin e marrëdhënies me familjet e rasteve të reja

Ndërgjegjësim për rëndësinë e rolit prindëror në mbarëvajtjen e detyrimeve të caktuara në vendimin e gjykatës

Trajtimi i vështirësive në komunikim që kanë prindërit me fëmijët dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme.

Këshillimi psikologjik është fokusuar në:

Ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e kryerjes së dënimit

Njohjen e pasojave të moskryerjes së veprës penale

Rritjen e sensit të korrektësisë dhe përgjegjësinë lidhur me detyrimet në jetën e përditshme

Formimin e marrëdhënieve ndërpersonale të shëndetshme dhe sidomos në sjelljet problematike me figurat autoritare.

Kurset profesionale: ofrohet asistim dhe këshillim për të vendosur kursin profesional që mendojnë se do t'u shërbejë në zotërimin e aftësive të nevojshme për të punuar në të ardhmen.

Janë trajtuar edhe raste të të miturve, të cilët kanë qenë përdorues të lëndëve narkotike, nevojë direkte ose indirekte që ka vepruar si shtysë në kryerjen e një vepre penale.

Disa nga arsyet e përdorimit të substancave kanë qenë faktorë individualë, biologjikë, shoqërorë, mjedisorë, etj.

Puna me të miturit, përdorues të lëndëve narkotike, kryhet nga specialistët e Shërbimit të Provës të cilët bëjnë:

- vlerësimin
- stilet efektive të ndërhyrjes
- planifikimin e mbikëqyrjes
- zbatimin e planit të mbikëqyrjes
- parandalimin e regresit dhe mbajtjen e ndryshimit

Prioritet në punën me të miturit ka qenë edhe vendosja e kontaktit mes Shërbimit të Provës dhe shkollave, e cila ka rezultuar ndërhyrje efektive me shkelësit e rinj duke përfshirë të miturit në periudhë prove apo të miturit të dënuar me punë në interes publik. Qëllimi i punës ka konsistuar në: nxitjen e të miturit për të frekuentuar shkollën, monitorimin e performancës në mësime dhe sjelljen e të miturve brenda këtyre ambienteve.

Në kuadrin e rehabilitimit të të miturve gjatë periudhës së provës, vazhdon projekti i bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me Drejtorinë Arsimore Berat, Korcë dhe Durrës. Ky projekt synon të integrojë praktikat e planeve individuale të trajtimit, të hartuara nga Shërbimi i Provës, me këshillimet psikologjike, shkollore dhe të formimit profesional të të miturve, përmes kurseve specifike, të ofruara nga këto drejtori.

Gjithashtu, në lidhje me integrimin pozitiv të të miturve në mbikëqyrje përmes kurseve, vlen të përmendet edhe projekti-pilot për zhvillimin e kursit të gjuhës angleze, mundësuar nga Shoqata Jo-fitimprurës "The Ideas Partnership", në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës. Ky projekt, me kohëzgjatje katër-mujore, ka patur si synim ofrimin e kurseve falas të gjuhës angleze për të miturit në mbikëqyrje dhe aftësimin e tyre drejt njohurive, vlerave arsimore dhe aktiviteteve prosociale. Ecuria e mbarëvajtjes së këtij projekti është mbikëqyrur vazhdimisht nga stafi i Shërbimit të Provës duke rezultuar në përmbushjen me sukses të objektivave të tij.

Të miturit dhe puna në interes publik

Specifikisht, për të realizuar mbarëvajtjen e kryerjes nga ana e të miturit të Punës me Interes Publik, Shërbimi i Provës bashkëpunon me një sërë organizatash për një ndërhyrje të

strukturuar duke ofruar shërbime të specializuara dhe në përputhje me nevojat e të miturve. Një bashkëpunim i tillë realizohet edhe me OJF, të cilat ofrojnë mbështetjen e nevojshme ndaj të miturve, për të cilët gjykata ka vendosur kryerjen e një pune në interes publik. Tregohet kujdes që i mituri ta kryejë punën sa më pranë vendbanimit të tij, në mënyrë që të vazhdojë normalisht funksionet në jetën e tij të përditshme. Gjithashtu, puna që i mituri kryhen, është në përshtatje me moshën e tij. Për të realizuar me sukses dënimin ofrohet shërbim i koordinuar dhe shkëmbim informacioni i vazhdueshëm mes Sh.P.-së dhe OJF-ve.

Në kuadrin e menaxhimit më efektiv të integrimit të të miturve në konflikt me ligjin, të cilët kanë marrë dënimin alternativ "punë në interes publik", Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me mbështetjen e UNICEF ka publikuar më 29 tetor 2014 hartat e Google, të hartuara për zyrat vendore të Shërbimit të Provës në Shqipëri. Aplikimi i kësaj teknologjie moderne i jep mundësi çdo specialisti të zyrave të shërbimit të provës të aksesojë në hartë të gjitha qendrat pritëse të identifikuara nga UNICEF si vende ku mund të referohen rastet e të miturve në konflikt me ligjin .Kjo praktikë e re vjen si domosdoshmëri e rritjes së efektivitetit të menaxhimit të rasteve të të miturve në mbikëqyrje nga ana e punonjësve të shërbimit të provës.

Aplikimi i sistemit të hartave Google ka mundësuar referime më të përshtatshme të të miturve në qendrat pritëse, konform nevojave të tyre për integrimin sa më pozitiv në shoqëri si dhe bashkëpunimin më të mirë të zyrave të shërbimit të provës me gjykatat apo njësitë e qeverisjes vendore.

Rast praktik: Puna në interes publik

Agroni, i cili aktualisht është 36-vjeçar dhe prind i dy fëmijëve, pasi është ndaluar nga forcat e policisë rrugore, ka rezultuar se ka qenë duke ngarë një motor pa dëshminë e aftësisë përkatëse. Për këtë arsye gjykata e ka dënuar me 20 ditë burgim, dënim, të cilin ia ka zëvendësuar me kryerjen e 60 orëve punë në interes publik.

Agroni ka pranuar dhe është i ndërgjegjshëm për veprimet e tij, të cilat kanë çuar në këtë dënim dhe është treguar bashkëpunues dhe i angazhuar gjatë punës me shërbimin e provës. Pas vlerësimit individual të rrezikshmërisë, Agroni rezulton se paraqet rrezikshmëri të ulët si për komunitetin ashtu dhe për përsëritjen e veprës penale, ndonëse problemet ekonomike të familjes së tij janë të theksuara.

Pas përcaktimit të vendit ku Agroni do të japë kontributin e tij në formën e punës në interes publik, u vendos bashkërisht se këto orë pune do të kryheshin pranë komunës ku ai banon. Kjo punë, e cila ka konsistuar në punë të lehta krahu, si p.sh., mirëmbajtja e gjelbërimit dhe ambientit publik, është realizuar nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës dhe punonjësit social të komunës sipas një programi kohor të përcaktuar.

Në përfundim të detyrimeve të tij, Agroni është shprehur se me anë të kryerjes së punës ai ka filluar të mendojë më thellë dhe të kuptojë veprimet e tij, të cilat kanë çuar drejt sjelljes kundërvajtëse dhe se kjo ka qenë mënyra e tij për të dhënë kontributin e vet për komunitetin.

KREU VIII - MBIKËQYRJA ELEKTRONIKE

Çfarë është?

Mbikëqyrja Elektronike është një nga reformat e realizuara në sistemin e drejtësisë penale shqiptare dhe ka filluar funksionimin në Mars të vitit 2013. Institucioni realizues i mbikëqyrjes elektronike është Shërbimi i Provës.

Mbikëqyrja elektronike përdoret për personat të cilët janë subjekt i :

- Masave shtrënguese (Kodi Procedurës Penale, pikat a, c dhe d),
- Dënimeve alternative (Kodi Penal, neni 58, 59, 59/a dhe 64)
- Dënimeve plotësuese (Kodi Penal, paragrafi 7 i nenit 30)
- Urdhrave të mbrojtjes ose urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes (ligj nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar., neni 17 dhe 19)

Kufizimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor, mbikëqyrjen nëpërmjet sallës operative ngritur për këtë qëllim, nëpërmjet pajisjes, e cila vendoset në trupin e personit. Pajisja i komunikon sallës operative daljen nga zona e lejuar apo hyrjen në zonën e ndaluar, duke treguar vendndodhjen e personit të mbikëqyrur.

Kush mund të mbikëqyret elektronikisht?

Gjykata ose prokuroria kërkojnë zbatimin e mbikëqyrjes elektronike për persona të mitur apo të rritur, të cilët paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe personat, të cilët akuzohen për një vepër penale, që dënohet jo më shumë se me 5 vjet burgim. Personi duhet të japë pëlqimin për t'u vënë në mbikëqyrje elektronike përveçse në rastet kur parashikohet në ligj. Aktorët e rëndësishëm të këtij procesi janë Gjykata, Prokuroria, Policia e Shtetit dhe Shërbimi i Provës.

Si funksionon?

Mbikëqyrja elektronike funksionon nëpërmjet një byzylyku elektronik (njësia personale) dhe një njësie qendrore (njësia e shtëpisë).

Byzylyku vendoset mbi kyçin e këmbës së personit dhe mbahet nga personi në çdo moment. Ai ka peshë të lehtë, është rezistent ndaj goditjeve dhe ujit gjë që bën të mundur vazhdimin e aktiviteteve normale të përditshme pa u penguar nga pajisja.

Njësia qendrore (njësia e shtëpisë), vendoset në shtëpinë e personit dhe merr sinjale në çdo kohë nga byzylyku elektronik, informacion, i cili përçohet drejt sallës operative nga ku bëhet mbikëqyrja elektronike. Nëse personi largohet nga zona e lejuar, komunikimi mes këtyre dy pajisjeve shkëputet. Në këtë moment, sinjalizohet salla operative për ngjarjen. Procesi i anasjelltë vlen për hyrjen në zonën e ndaluar. Sinjale të tjera, që i dërgohen sallës operative sipas rastit, janë ato kur pajisja dëmtohet, tentohet të hiqet, lëvizet, apo nëse nuk është e lidhur me energjinë elektrike.

Çfarë ndodh nëse shkelen kushtet?

Në momentin kur kryhet një shkelje e përcaktimeve të vendimit gjyqësor, salla operative konfirmon ndodhinë dhe informon autoritetet përkatëse. Shkelja e detyrimeve, nëse e

qëllimshme apo e përsëritur, mund të riçojë personin para gjykatës dhe mund të rezultojë në zëvendësimin apo revokimin e mbikëqyrjes elektronike.

Cili është përfitimi?

Mbikëqyrja Elektronike ofron një sistem të fuqishëm për përforcimin e efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për personat të cilëve iu është kufizuar lëvizja dhe mund të promovojë rritjen e sigurisë publike duke përmirësuar mbikëqyrjen e individëve në komunitet. Kufizimi i lëvizjes gjithashtu mund të ndihmojë në imponimin e një disipline dhe strukture ditore për të mbikëqyrurit; të ndikojë në thyerjen e trajtave të sjelljes kriminale dhe mund të aftësojë pjesëmarrjen në aktivitete pune, arsimimi apo trajnimi.

KREU IX – SHËRBIMI I PROVËS DHE SHTETASIT E HUAJ

Shërbimi i Provës i trajton të dënuarit e huaj në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë duke respektuar parimet e reciprocitetit, të mosdiskriminimit dhe trajtimit jo më pak të favorshëm se shtetasit shqiptarë.

Kur një i dënuar vuan dënimin e tij për një vepër që ka kryer në territorin e Republikës së Shqipërisë, ai mund të kërkojë nga gjykata aplikimin e një prej alternativave të dënimit me burgim pasi të ketë përmbushur kushtet ligjore për një dënim të tillë. Të dënuarit që janë shtetas të huaj kanë të drejta të barabarta si ata me shtetësi shqiptare, bazuar në "Konventën evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht"-ligji nr. 8724, datë 26.12.2000. Shërbimi i Provës ka detyrimin që të sigurojë komunikimin në gjuhën amëtare ose në një gjuhë ndërkombëtare për shtetasit e huaj, të cilët kanë kryer një vepër penale dhe kanë marrë një dënim alternativ.

Shërbimi i Provës është përgjegjës për mbikëqyrjen e të dënuarve, pavarësisht nga shtetësia që ata kanë. Shërbimi i Provës ka kompetenca që të mbikëqyrë këta të dënuar brenda Republikës së Shqipërisë, kur vendbanimi i tyre është në Shqipëri. Për ata shtetas që kanë vendbanimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Shërbimi i Provës, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, bën të mundur ekzekutimin e vendimit të gjykatës në shtetin ku i dënuari ka vendbanimin, nëse ekziston një marrëveshje midis dy shteteve për këtë gjë.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, pranë gjykatës që ka dhënë vendimin për dënimin alternativ të shtetasit me banim në një shtet tjetër, deri në marrjen e një përgjigjeje nga ana e shtetit të kërkuar, nëse e pranon apo e refuzon mbikëqyrjen për shtetasin e dënuar nga gjykata e shtetit shqiptar, ka detyrimin që të vazhdojë mbikëqyrjen sipas legjislacionit të shtetit shqiptar.

Që nga fillimi i institucionit të Shërbimit të Provës në Shqipëri, gjykatat shqiptare kanë aplikuar alternativat e dënimit me burgim si "Lirim me kusht" dhe "Pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim", për një numër shtetasish të huaj, në konflikt me ligjin.

KREU X - KOMPETENCA TOKËSORE DHE STRUKTURA E SHËRBIMIT TË PROVËS

Shërbimi i Provës është i organizuar në nivel qëndror dhe vendor. Niveli qëndror i tij përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, ndërsa Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës funksionojnë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe përbëjnë nivelin vendor.

Kompetenca tokësore e Shërbimit të Provës përcaktohet nga Rregullorja[1] e Shërbimit të Provës me qëllim që të përcaktojë se cila zyrë vendore e Shërbimit të Provës ka kompetencë mbi një rast të caktuar.

Në nenin 5, Rregullorja e Shërbimit të Provës parashikon kriteret që merren parasysh se cila zyrë vendore ka kompetencë mbi një rast të caktuar. Si rregull i përgjithshëm, kur i dënuari nuk burgoset, vendi i rezidencës/banimit të të dënuarit (të vendosur nën mbikëqyrje apo që është subjekt i një raporti vlerësimi) përcakton kompetencën tokësore të Shërbimit të Provës. Për të dënuarit, të cilët janë duke vuajtur dënimin me burgim dhe që janë subjekt i programeve rehabilituese, Shërbimi i Provës më i afërt me burgun është ai që ka kompetencën në këtë rast.

Kompetenca tokësore e Shërbimit të Provës përcaktohet nga Rregullorja[2] e Shërbimit të Provës me qëllim që të përcaktojë se cila zyrë vendore e Shërbimit të Provës ka kompetencë mbi një rast të caktuar.

Detyrat kryesore të Shërbimit të Provës janë: të përgatisë raporte për gjyqtarët e prokurorët dhe të mbikëqyrë të dënuarit në komunitet. Aktiviteti i tij fokusohet drejt të dënuarit dhe jo aq shumë drejt krimit(ve) të kryer(a). Për pasojë, kompetenca tokësore nuk mund të identifikohet me atë të gjykatës, pranë së cilës janë vendosur këto zyra të Shërbimit të Provës.

Në nenin 5, Rregullorja e Shërbimit të Provës parashikon kriteret që merren parasysh se cila zyrë vendore ka kompetencë mbi një rast të caktuar. Si rregull i përgjithshëm, kur i dënuari nuk burgoset, vendi i rezidencës/banimit të të dënuarit (të vendosur nën mbikëqyrje apo që është subjekt i një raporti vlerësimi) përcakton kompetencën tokësore të Shërbimit të Provës. Për të dënuarit, të cilët janë duke vuajtur dënimin me burgim dhe që janë subjekt i programeve rehabilituese, Shërbimi i Provës më i afërt me burgun është ai që ka kompetencën në këtë rast.

Në fillimet e para të aktivitetit të këtij shërbimi, në bazë të Urdhrit nr. 67, datë 06.05.2009, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të Shërbimit të Provës", u krijuan katër zyra vendore, me vendndodhje pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Fier.

Këto zyra kishin problem me funksionimin e tyre për shkak të kompetencës tokësore të tyre të parashikuar në Rregulloren e Shërbimit të Provës. Zyrat vendore të Shërbimit të Provës i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore në vendin ku i dënuari vuan dënimin dhe në vendin ku i dënuari i vënë në provë ka banimin. Me qëllim mirëfunksionimin e Shërbimit të Provës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ka dalëUrdhri nr. 5331/1, datë 06.07.2009, i Ministrit të Drejtësisë, i cili përcakton kompetencat tokësore të zyrave vendore të Shërbimit të Provës.

Pas daljes së Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 01.07.2010, "Për miratimin e organikës dhe strukturës së Shërbimit të Provës", këtij Shërbimit iu shtuan edhe katër zyra vendore me vendndodhje në qytetet Elbasan, Lezhë, Korçë dhe Gjirokastër. Këto zyra i shtrijnë kompetencat tokësore të tyre në rrethet gjyqësore të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr.

1. Vendim Nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative'"
1. Vendim Nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative'"

7746/1, datë 24.09.2010, "Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave tokësore të zyrave vendore të Shërbimit të Provës".

Me Urdhrin Nr. 2, datë 11.01.2012, të Kryeministrit, u hapën edhe katër zyra të tjera vendore, përkatësisht në Kukës, Burrel, Berat dhe Vlorë, duke çuar numrin e zyrave vendore në shifrën 12.

Me Urdhër të Kryeministrit nr. 100, datë 28.02.2014, "Për miratimin e organikës dhe strukturës së Shërbimit të Provës", Shërbimi i Provës nga 12 zyra vendore që kishte në vitin 2013, ka aktualisht 22 zyra të tilla, të shpërndara pranë rretheve gjyqësore, me anë të të cilave synohet qe te ofrohet nje sherbim sa me prane nevojave te publikut.

Sipas këtij urdhri, në territorin e Republikës së Shqipërisë, Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës kanë vendndodhjen dhe kompetencën tokësore si më poshtë:

1. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Tiranë dhe vendndodhje në qytetin Tiranë.
2. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Durrës dhe vendndodhje në qytetin Durrës.
3. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Shkodër dhe vendndodhje në qytetin Shkodër.
4. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Fier dhe vendndodhje në qytetin Fier.
5. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Lezhë dhe vendndodhje në qytetin Lezhë.
6. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Elbasan dhe vendndodhje në qytetin Elbasan.
7. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Korçë dhe vendndodhje në qytetin Korçë.
8. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Gjirokastër dhe vendndodhje në qytetin Gjirokastër.
9. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Mat dhe vendndodhje në qytetin Burrel, Mat.
10. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Berat dhe vendndodhje në qytetin Berat.
11. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Vlorë dhe vendndodhje në qytetin Vlorë.
12. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Kukës dhe vendndodhje në qytetin Kukës.
13. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Kavajë dhe vendndodhje në qytetin Kavajë.
14. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Krujë dhe vendndodhje në qytetin Krujë.
15. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Pukë dhe vendndodhje në qytetin Pukë.

16. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Kurbin dhe vendndodhje në qytetin Kurbin.
17. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Pogradec dhe vendndodhje në qytetin Pogradec.
18. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Përmet dhe vendndodhje në qytetin Përmet.
19. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Sarandë dhe vendndodhje në qytetin Sarandë.
20. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Dibër dhe vendndodhje në qytetin Peshkopi
21. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Tropojë dhe vendndodhje në qytetin Tropojë
22. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, me kompetencë tokësore në rrethin gjyqësor Lushnje dhe vendndodhje në qytetin Lushnje.

Struktura aktuale e shërbimit të provës.



a. Personeli

Shërbimi i Provës mbi bazën e ligjit nr.152 të vitit 2013, "Për nëpunësit civil" dhe gëzon statusin e nëpunësit civil. Rekrutimi, përzgjedhja, emërimi, promovimi masat disiplinore etj., për punonjësit e shërbimit të provës përcaktohen po në këtë ligj.

Pjesëtarë të ndryshëm të personelit luajnë role të ndryshme në shërbimin e provës dhe për pasojë, nevojiten nivele të ndryshme arsimi dhe trajnimi. Aktualisht, në përbërjen e Shërbimit të Provës kemi juristë, psikologë, sociologë dhe punonjës socialë. Gjatë vitit 2014 numri i stafit duke konsideruar edhe hapjen e zyrave të reja vendore ka shkuar nga 108 në vitin 2013, në 134 në vitin 2014.

Në faza të ndryshme të karrierës së tyre, synohet që i gjithë personeli të ketë mundësi për arsim dhe trajnime, në mënyrë që të sigurohet cilësia më e mirë e shërbimeve të ofruara. Këto trajnime kanë lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe janë të dobishme për zhvillimin e tyre profesional.

Trajnimet fillestare kanë synuar përgatitjen e personelit që të jenë të aftë punojnë në rolin e tyre të ri profesional. Trajnimet gjatë punës duhet t'u ofrohen të gjithë pjesëtarëve të personelit. Kjo nevojitet për t'u njohur me legjislacionin, politikat dhe praktikat e reja, si dhe me zhvillime të tjera që lidhen me këtë fushë. Në të njëjtën kohë, duhet të ketë trajnime që u japin mundësi punonjësve të lëvizin në role të reja sipas kërkesave të agjencisë, të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, si dhe të nxisë diversitetin.

Është thelbësore që personeli përgjegjës për menaxhimin të ofrojë drejtim dhe udhëheqje. Gjatë vitit 2014 janë organizuar një sërë takimesh periodike me drejtuesit e zyrave, në të cilat është diskutuar ecuria në tërësi e realizimit të detyrave, pengesat, shkaqet rekomandimet dhe ndërhyrje e mundshme për zgjidhjen e problemeve specifike etj..

Trajnimi i vazhdueshëm i stafit.

Gjithashtu, stafi i cili përkujdeset në mënyrë të drejtpërdrejtë është trajnuar vazhdimisht për të rritur aftësitë profesionale. Kështu, gjatë vitit 2014, falë mbështetjes së vazhdueshme të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ,30 punonjës të Shërbimit të Provës u trajnuan mbi "Implementimin e vlerësimit të rrezikshmërisë për të miturit dhe të rinjtë në moshë madhore" (SVRMR). Implementimi i këtij instrumenti vjen në kuadrin e plotësimit të një mangësie të mëparshme në punën me të dënuarit e mitur, atë të mungesës së një sistemi vlerësimi të posaçëm për të miturit. Përmes aplikimit të këtij sistemi, punonjësi i Shërbimit të Provës ka mundësi të trajtojë më efektivisht të miturit në konflikt me ligjin, të identifikojë në mënyrë më objektive shkaqet dhe rrethanat e veprës penale, parashikimit të saj, rrezikshmërisë dhe kontrollit më të mirë të të dënuarve të mitur.

Po gjatë vitit 2014, në funksion të përmirësimit të praktikave të vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve nën mbikëqyrje janë trajnuar 25 punonjës të Shërbimit të Provës me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Vit pas viti ,Shërbimi i Provës ka njohur suksese progresive në minimizimin e kostove dhe efekteve negative të dënimit me burgim. Një arritje e madhe në këtë drejtim mbetet shtimi i vazhdueshëm i numrit të të dënuarve të mitur me dënime alternative. Për t'iu përgjigjur sa më mirë këtij realiteti, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri ka realizuar trajnime gjatë

vitit 2014 me punonjësit e Shërbimit të Provës me synim njohjen më të thellë të aspekteve specifike të punës me të dënuarit e mitur. Kjo nismë është reflektuar në rritjen e vazhdueshme profesionale të punonjësve të Shërbimit të Provës, specifikisht në hartimin dhe implementimin e planeve dhe praktikave më të efektshme të trajtimit të të dënuarve të mitur në komunitet dhe në adresimin më të mirë të nevojave dhe të riskut që paraqesin të dënuarit e mitur.

Aftësimi profesional i punonjësve të Shërbimit të Provës ka vazhduar dhe më tej gjatë vitit 2014, periudhë gjatë së cilës Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ka realizuar trajnime me fokus përmirësimin e mëtejshëm të praktikave dhe instrumenteve të vlerësimit të rrezikshmërisë tek shkelësit e ligjit, si dhe atyre të drejtësisë restauruese. Konkretisht, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka kryer trajnime të 20 punonjësve të Shërbimit të Provës mbi institucionet penale, me fokus rritjen e njohjes nga stafi i shërbimit të provës të masave alternative të dënimit me burgim. Trajnimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës janë shtrirë dhe në zyrat vendore si ato të Beratit, Kurbinit, Gjirokastrës, Shkodrës, Vlorës etj., në bashkëpunim me Fondacionin për Zgjidhjen e Konflikteve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve dhe UNICEF. Këto trajnime janë realizuar me 40 punonjës të shërbimit të provës dhe në fokus ka qënë përrmirësimi i zbatimit të parimeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë-kundravajtës në zgjidhjen e konflikteve penale.

Po gjatë vitit 2014, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, duke patur si prioritet rritjen e efektivitetit të punës me të miturit nën mbikëqyrje, në bashkëpunim me QSHPLI dhe “Save the children” ka realizuar një trajnim për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Shërbimit të Provës për lehtësimin e praktikave të ndjekura prej tyre gjatë procesit të trajtimit të të miturve me dënime alternative

Nismat dhe projektet konkrete për trajnimin e vazhdueshëm të stafit, të ndërmarra nga Shërbimi i Provës gjatë këtyre viteve, kanë ndihmuar në identifikimin e aspekteve profesionale të punonjësit të Shërbimit të Provës, mbi të cilat këto nisma dhe projekte duhet të vazhdojnë të aplikohen në të ardhmen, të tilla si:

- Thellimi i njohjes së stafit me kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij në fushën e drejtësisë penale;
- Përmirësimit të punës me të miturit dhe me grupet vulnerabël si dhe implikimet ligjore të tij;
- Respektimi i të drejtave të njeriut;
- Referimin në konventat dhe rekomandimet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale për praktika sa më bashkëkohore pune me institucionet e drejtësisë penale;
- Zgjerimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e drejtësisë penale
- Rritjes së rolit dhe masës së zbatimit të praktikave të drejtësisë restauruese në fushën e drejtësisë penale;
- Përmirësimit të shkrimit dhe raportimit ligjor;
- Përmirësimit të zbatimit të sistemit të vlerësimit të rrezikshmërisë, si për të rriturit ashtu dhe për të miturit nën mbikëqyrje;
- Përmirësimit dhe implementimit sa më efikas të strategjive dhe politikave kombëtare në lidhje me kriminalitetin dhe parandalimin e tij;
- Bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Provës me organizata dhe institucione të arsimit të lartë në Shqipëri për studi, veçanërisht në fushën e drejtësisë për të miturit.

KREU XI - STATISTIKA

Statistika përmbledhëse

Për vitin 2014 rezulton pothuajse i dyfishuar aplikimi i alternativave të dënimit me burgim duke arritur në 4003 Urdhra Ekzekutimi. Është dyfishuar pothuajse aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, duke shkuar nga 1758 në 3189 pezullime të dënimit me burgim dhe vendosje në periudhë prove. Rritje të lartë verifikohet edhe për aplikimin e alternativës së parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal "Punë në Interes Publik". Kështu nga 145 vendime për punë në interes publik për vitin 2013 janë dhënë 694 vendime për vitin 2014. Për një zbatim sa më efektiv të kësaj alternative dhe për një aplikimin më të prekshëm nga komuniteti, Shërbimi i Provës gjatë vitit 2014 ka zgjeruar ndjeshëm institucionet ku zbatohet kjo masë duke përfshirë kështu jo vetëm pushtetin vendor shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e fëmijës, qendrat spitalore dhe arkeologjike, bibliotekat etj.

Shërbimi i Provës merr pjesë në mënyrë aktive gjatë të gjitha fazave të procedimit penal, pra gjatë fazës së hetimit, fazës së gjykimit dhe gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Përsa i përket fazës së hetimit Shërbimi i Provës me kërkesë të prokurorit harton një raport vlerësues të të pandehurit ku pasqyron në mënyrë analitike kushtet dhe rrethanat shoqërore të tij.

Besimi te efikasiteti i masave alternative rezulton në rritje edhe për organin e akuzës. Kështu referuar të dhënave statistikore për vitin 2014 janë kërkuar 155 Raporte Vlerësimi kryesisht për të miturit dhe kjo përbën një shifër e cila respekton trendin në ulje të verifikuar edhe për vitet e mëparshme.

Për vitin 2014 punonjësit e Shërbimit të Provës kanë hartuar 446 Raporte Vlerësimi për gjykatat dhe referuar të dhënave për vitin e mëparshëm rezulton në ulje kërkesa për vlerësimi edhe për faktin se është zbatuar ligji për aministinë.

Të dënuar në mbikëqyrje (Për periudhën 01.06.2009-31.12.2014)

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	2009-2010	2011	2012	2013	2014	Totali
1	Neni 59 i KP, Pezullimi	2012	1616	2166	1758	3189	10741
2	Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	43	68	34	36	56	237
3	Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	283	206	188	147	64	887
4	Neni 63 i KP, Punë në interes publik	214	226	214	145	694	1493
5	Neni 58 i KP, Gjysmëliria	0	1	0	0	0	1
TOTALI		2552	2117	2602	2086	4003	13359

Numri total i të dënuarve sipas llojit të dënimeve alternative (Për periudhën 01.06.2009-31.12.2014)

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Totali
1	Neni 59 i KP, Pezullimi	10741
2	Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	237
3	Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	887
4	Neni 63 i KP, Punë në interes publik	1493
5	Neni 58 i KP, Gjysmëliria	1
TOTALI		13359

Numri i të dënuarve sipas periudhës së provës (Për vitin 2014)

KOHA E PROVËS	Totali
Dënime < 18 muaj	72
18 MUAJ - 3 VJET	2867
3 VJET	317
4 VJET	33
5 VJET	20
TOTALI	3309

Numri i të dënuarve sipas sasisë së orëve të punës në interes publik (Për vitin 2014)

Orë Pune në Interes Publik	Nr i të dënuarve
30 orë	1
45 orë	2
40 orë	79
50 orë	36
56 orë	1
60 orë	96
80 orë	149
90 orë	4
100 orë	160
120 orë	83
140 orë	4
150 orë	24
160 orë	12
180 orë	11
200 orë	18
240 orë	14
TOTALI	694

Kërkesa për raporte vlerësimi (për vitin 2014)

Kërkesa për raporte vlerësimi	Totali
Gjykata	446
Prokuroria	155
TOTALI	601